



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10070 prot.

Vlorë, më 25.08 2023

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_ .2023

**“PËR SHTYRJE TË AFATIT TË KONTRATËS PËR ADMINISTRIMIN DHE  
FINANCIMIN E SHOQËRISË FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SH.A”**

Në bazë të nenit 8/2, 9/1.2, 25/4, 54 të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.79/2017, "Për sportin" neni 20, neni neni 33, neni 39 e vijim, ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" neni 135, neni 167, Statutit dhe Aktit të Themelimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club", Rregullorja dhe Statuti i Federatës Shqiptare të Futbollit, VKB nr.39 datë 31.07.2014 "Për disa ndryshime në administrimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a", VKB nr.38 datë 01.08.2016 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a", VKB nr.89 datë 26.07.2018 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a", VKB nr.64 datë 14.08.2020 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a", "Marrëveshjes së financimit dhe administrimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club" të lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërive "TRK GROUP dhe ATLAS Global", VKB nr.53 datë 26.08.2021 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Flamurtari Football Club Sh.A" Këshilli Bashkiak Vlorë, në mbledhjen e datës \_\_\_\_ .08. 2023,

**VENDOSI**

1. Të miratohet shtyrja për një periudhë 1 vjecare e afatit të kontratës së financimit dhe administrimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club" të lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërive "TRK GROUP + ATLAS Global".
2. Pavarësisht përcaktimit në pikën 1, efektet e kontratës së financimit dhe administrimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club" përfundojnë me shitjen e aksioneve të kësaj shoqërie, aktualisht në pronësi të Bashkisë Vlorë.
3. Administrata e bashkisë Vlorë të kryejë procedurat për shitjen e aksioneve të shoqërisë "Flamurtari Football Club" në pronësi të saj, si dhe për përcaktimin e statusit juridik të ekipit të futbollit "Flamurtari".
4. Të miratohen emrat e Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, si më poshtë vijon:
  - a) Sinan Idrizi
  - b) Kreshnik Cipi
  - c) Robert Islamaj
  - d) Propozim nga Këshilli Bashkiak


Kohëzgjatja e mandatit e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë një vit.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”.

**GRUPI I KËSHILLTARËVE TË PARTISË SOCIALISTE**

**KRYETARI**

**Ervis Moçka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRUPI I KËSHILLTARËVE TË PARTISË SOCIALISTE

Nr. 10070 Prot

Vlorë, më 25.08 2023

RELACION

**“PËR SHTYRJE TË AFATIT TË KONTRATËS PËR ADMINISTRIMIN DHE FINANCIMIN E SHOQËRISË FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SHA”**

Sikurse jeni në dijeni, shoqëritë TRK dhe Atlas Global, në bazë të vendimeve të Këshillit Bashkiak Vlorë, kanë lidhur një marrëveshje për financimin dhe administrimin e shoqërisë Flamurtari F.C. sh.a, duke marrë përsipër financimin e të gjithë aktivitetit sportiv, i cili është objekt i veprimtarisë së kësaj shoqërie. Gjate kësaj periudhe disavjecare, financimi i aktivitetit të kësaj shoqërie është kryer prej shoqërive financuese, duke sjellë kursime në të ardhurat e Bashkisë Vlorë gjatë këtyre viteve.

Ky bashkëpunim është realizuar bazuar në disa vendimmarrje të Këshillit të Bashkisë Vlorë, sikurse janë VKB nr.39 datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime në administrimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a”, apo VKB-të nr.38 datë 01.08.2016, VKB nr.89 datë 26.07.2018, VKB nr.64 datë 14.08.2020 “Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a” dhe VKB nr.53 datë 26.08.2021 “Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a”.

Bazuar në ligjin nr.79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar me ligjin nr.105/2020 datë 29.07.2020, në nenin 22 përcaktohet se

Neni 22 Kapitali shtetëror

1. Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
2. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.
- 3. Nëse në përfundim të periudhës një vjeçare, aksionet e zotëruara nga institucionet publike në shoqëritë tregtare sportive nuk shiten, këto të fundit marrin formën sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji.**

Këshilli bashkiak në mbledhjen e datës 26 Gusht 2021, ka vendosur për shtyrjen e afatit të kontratës për një afat 2 vjecar, si dhe vijimin e procedurave të tjera, për shkak se Bashkia Vlorë nuk i kishte kryer procedurat e nevojshme, në zbatim të ligjit, ligj ky, i cili ka hyrë në fuqi në datë 10.09.2020 (15 ditë pasi është botuar në fletoren zyrtare 154 datë 26.08.2020), me afat të caktuar



të nxjerrjes në shitje të aksioneve ,brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit. Ky afat përfundonte në 10 Shtator 2021.

Bashkia Vlorë si zotëruese e aksioneve të shoqërisë “Flamurtari Football Club sh.a”,edhe sot pas dy vitesh, nuk e ka kryer shitjen e aksioneve që zotëron dhe as nuk e ka nisur procedurat, e për pasojë, kjo shoqëri duhet të mbajë formën sipas sipas përcaktimeve të nenit 21 të ligjit “Për Sportin”. Në nenin 21 të ligjit , përcaktohet :

#### Neni 21 Klubet sportive

1. Klubet sportive organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse ose tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
2. Çdo organizatë, që ka personalitet juridik, ka të drejtë të krijojë një shoqatë sportive amatore sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse, e cila organizohet dhe funksionon në bazë të aktit themelues të organit krijues.
3. Transformimi i klubeve sportive sipas pikës 1 të këtij neni, realizohet me vendim të organit krijues brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Klubet sportive sipas pikës 1 të këtij neni, përfitojnë financime nga organet e pushtetit vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Sipas këtij neni, kjo shoqëri duhet të funksionojë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse dhe shoqëritë tregtare, ose të kthehet në klub sportiv.

Përvec sa më lart, në bazë të këtij ligji në pikën e fundit përcaktohet se *“Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8 dhe 15 të këtij ligji.”*.

#### Neni 8 Ministria përgjegjëse për sportin dhe njësitë e qeverisjes vendore

1. Ministria përgjegjëse për sportin harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive.
2. Ministria përgjegjëse për sportin bashkë-punon me to për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion, dhe financon ndërtimin e mirëmbajtjen e mjediseve sportive.
3. Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikën vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitare, krijon institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre.

Referuar nenit 8 të ligjit, për të cilin ende nuk janë nxjerrë aktet nënligjore, është pikërisht ky nen që ka të bëjë me marrëdhëniet me pushtetin vendor dhe nuk ka mundur të përcaktojë se si pushteti vendor mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre, sikurse është edhe shoqëria sportive objekt i këtij projekt vendimi.

Në përfundim dhe ndodhur përpara kësaj situatë faktike dhe ligjore, Grupi i Këshilltarëve të socialist, është i mendimit, që të vazhdojnë bashkëpunimin me shoqëritë TRK GROUP + ATLAS Global për financimin e “Flamurtari Football Club sh.a” për një periudhë 1 vjecare, i cili shpresojmë të japë kohën e nevojshme për kryerjen e procedurave të shitjes së aksioneve, apo

formave të ndryshme të organizatave sportive që mund të përcaktohen nga legjislacioni shqiptar në vijim, si dhe të jepet mundësi për ringritjen e ekipit në vendin që i takon.

Në bazë të marrëveshjes së lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërive TRK GROUP + ATLAS Global, për mbikqyrjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe pjesë e vendimmarrjes së saj, Këshilli Bashkiak duhet të ketë përfaqësuesin e tij në këshillin drejtues të shoqërisë, kurse 3 anëtarët e tjerë do të propozohen nga shoqëritë financuese, që në fakt kanë rikonfirmuar në detyrë 3 anëtarët e mëparshëm z. Sinan Idriz, z.Kreshnik Cipi, z.Robert Islami.

Për sa më lart, ftojmë Këshillin e Bashkisë, që të propozojë dhe përzgjedhë një person, që të jetë pjesë e Këshillit Drejtues të shoqërisë Flamurtari F.C. sh.a, si dhe të votojnë këtë projektvendim.

Përfundimisht, ju ftojmë të miratoni këtë projektvendim me qëllim vazhdimin e procedurave të mëtejshme.

## **GRUPI I KËSHILLTARËVE TË PARTISË SOCIALISTE**

**KRYETARI**

**Ervis Moçka**

